

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NË SUHAREKË, Gjyqtari – **Durmish Berisha**, me sek. juridike – **Ajnishahe Berisha**, ne proceduren e kundervajtjes ndaj te pandehurit: **Ilirian Rilind Bytyqi nga fsh. Studenqan KK Suharekë**, per kundervajtjen e kryer nga neni 16 paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrëtarëve të Lartë Publik , si dhe ne bazë te nenit 73, 195 dhe 199 te Ligjit mbi kundervajtjet me dt. **15.02.2012**, merr ketë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Ilirian Rilind Bytyqi nga fsh. Studenqan KK Suharekë, i lindur më **04.06.1968**, ka të kryer shkollen e mesme, i martuar baba i 4- fëmijëve, me profesion, Drejtor i Inspeksionit dhe Administratës, gjer me tani kinse jo i denuar.

ESHTË PERGJEGJES

Per arsye se Zyrtari i Lartë Publik nuk e ka përmbushur obligimin ligjor mbrenda afatit për Deklarimin e Pasurisë në pajtim me nenin 6 dhe 7 të Ligjit me nr. 03/L-151.

Me kete veprim i pandehuri ka kryer kundervajtje nga neni 16 paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrëtarëve të Lartë Publik, e me aplikimin e të njejtit.

GJOBITET

Me gjobë në shumën prej **400 (Katërqind) €**, gjobën e shqiptuar duhet ta paguaj në afat prej 15 ditesh, nga dita e plotëfuqishmeris së ketij Aktvendimi, në favor te Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në xhirrollogarin nr.1000430070000518, e që pagesa bëhet permes kësaj gjykate.

Nese gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njejt do ti zëvendesohet me denim burgimi ne kohëzgjajte prej **26 - ditesh**, duke iu llogaritur nga 15 €, per nje ditë burgimi.

I pandehuri është i obliguar që në emer të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën paushalle prej **10 - €**, në afatin e njejtë sikurse gjobën e shqiptuar në të holla nën kërcnim të ekzekutimit me dhunë.

Me nga nje kopje të ketij aktvendimi duhet njoftuar parashtruesin e kerkeses dhe të pandehurin.

ARSYETIM

Me kërkesen e **Agjensisë Kundër Korrupsionit - Prishtinë** me nr. **01-3232/11** të dt. **14.07.2011**, është ngritur fletparaqitja per kundervajtje kunder të pandehurit me motivacion se ka kryer kundervajtje.

Gjykata në shqyrtimin kryesor mori në pyetje të pandehurin i cili deklaroi : Është e vërtetë se me dt. 15.03.2011, jam caktuar Drejtor për Administratë dhe Inspeksion në Kuvendin Komunal të Suharekës , dhe në fillim nuk kam ditur se kam qenë i obliguar që ta deklaroj Prejardhjen e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , pasi që unë në këtë vendë të punës punoj për here të pare. Pastaj jam njoftuar se në afat prej 60- ditësh nga data e emrimit në këtë post jam i detyruar që ta dërgoj formularin për deklarimin e pasurisë e që të njejtin në mënyrë elektronike e kam dërguar pas afatit, mirëpo me dt. 29.06.2011, e kam dërguar, e që Agjensioni kundër Korrupsionit e ka pranuar me dt. 04.07.2011, për qka dhe gjykatës I prezantoi edhe vertetimin e lëshuar nga Agjensioni kundër Korrupsionit me nr. DP03/3094/11, të dt. 04.07.2011. Pasi që për mua është hera e pare që është dashur të paraqes këtë formular dhe nuk e kam paraqitur me kohë I propozoj gjykatës që ndaj meje të shqiptohet një denim sa më I butë I paraparë me ligj , nga se herave të tjera nuk do të përsëris këso lloj të kundërvajtje.

Gjykata pas administrimit të provave në shkresat e lëndës, deklaratës së të pandehurit, konstatoi në mënyrë të themeltë, se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e me aplikimin e të njejtit gjykata të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe ia shqiptoi denimin me gjobë në të holla ashtu siq u cek në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata gjatë marrjes së këtij Aktvendimi pati parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese, të cilat ndikojnë në marrjen e këtij aktvendimi.

Me sa u cek me lartë u vendos si ne dispozitiv te ketij Aktvendimi

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË SUHAREKË

Sek. Juridike
Ajnishahe Berisha

Gjyqtari
Durmish Berisha

UDHEZIME JURIDIKE: Kunder këtij aktvendimi kanë të drejtë ankese i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së të njejtit. Ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj Gjykate.